

UDHËZIM PËRDORIMI

"Përdorimi i Aplikacionit INSTA PAY"

Përmbajtja

- 1. Përshkrimi
- 2. Aplikimi dhe aktivizimi i produktit BPB Insta Pay
- 3. Transaksionet e lejuara përmes BPB Insta Pay
- 4. Dalja nga aplikacioni
- 5. Resetimi i fjalëkalimit

6. Ndryshimi i numrit të telefonit dhe deaktivizimi i shërbimit BPB Insta Pay

1. PËRSHKRIMI

Aplikacioni BPB Insta Pay është produkt i ri i bankës, i cili ju mundëson edhe një kanal tjetër komunikimi elektronik me bankën.

Ky produkt do të ju ofrohet të gjithë klientëve të bankës të cilët kanë të hapur llogari rrjedhëse në valutën EUR në BPB dhe që janë mbajtës, respektivisht përfaqësues ligjor të llogarive të tyre individuale apo të biznesit.

Për të marrë këtë produkt bankar ju duhet që fillimisht të kenë qasje në internet dhe të shkarkoni aplikacionin, të regjistroheni sipas të dhënave të kërkuara, ndërsa **aktivizimi** apo përdorimi i aplikacionit mundësohet vetëm pas vizitës suaj në degë dhe nënshkrimit të kontratës së produktit BPB Insta Pay.

Në vazhdim janë listuar hapat që duhet të ndiqni gjatë këtyre proceseve:

2. APLIKIMI DHE AKTIVIZIMI PËR PRODUKTIN BPB INSTA PAY

Aplikimi për këtë produkt mundësohet për Klientët Individual dhe Klientët e Biznesit. Shkarkimi i aplikacionit BPB Insta Pay mundësohet përmes Play Store apo Apple Store, për telefonat Android dhe IOS:

- Ikona e aplikacionit do të duket si në vijim:



Pas shkarkimit të aplikacionit, ju duhet të regjistroheni duke plotësuar informatat e kërkuara varësisht nëse jeni klientë privat apo biznes.

Regjistrimi i klientëve

Hapat dhe informatat qe kërkohen gjatë regjistrimit janë përshkruar në vazhdim:

- Emri dhe mbiemri i klientit apo i përfaqësuesit ligjor (për biznese)
- Numri personal apo numri i regjistrimit të biznesit
- Numri i llogarisë rrjedhëse bankare në valutën EUR
- Katër numrat e fundit të debit kartelës të lëshuar nga BPB të lidhur me llogarinë rrjedhëse
- Kodi i shtetit plotësohet automatikisht me prefiksin e telefonisë mobile në Kosovë (+383)
- Numri i telefonit të klientit apo i përfaqësuesit ligjor të biznesit

Të gjitha të dhënat e mësipërme duhet të përputhen me të dhënat që i keni të ruajtura në sistemin e bankës paraprakisht, gjatë regjistrimit apo përditësimit të të dhënave. Për më tepër, llogaria dhe kartela duhet të jenë aktive. Pas plotësimit të informatave të mësipërme, do të ju mundësohet që përmes klikimit ne linkun "**Pranoj rregullat dhe kushtet e përgjithshme**" të lexoni "**Kushtet dhe afatet e përgjithshme të bankës**" dhe nëse pajtoheni të pranoni këto kushte duke klikuar në kutizën e vendosur te teksti me shenjën " √".



Aplikacioni ju mundëson të zgjedhni gjuhën gjatë përdorimit, në gjuhë shqipe apo gjuhë angleze.

Pas klikimit ne fushën "**Regjistrohu**" në numrin e telefonit, ju do të pranoni një sms me një kod një përdorimesh 6 shifror, të cilin duhet ta shkruani në mënyrë që të kompletoni procesin e regjistrimit:



Pas plotësimit të kodit 6 shifror, regjistrimi do të përfundoj me sukses dhe ju ipet mundësia e përcaktimit te fjalëkalimit, përmes të cilit do të kyçeni në aplikacion, pas aktivizimit të shërbimit





Pas përfundimit te këtij veprimi, ju duhet të vizitoni degën më të afërt të bankës për të përfunduar procesin e aktivizimit dhe nënshkruar kontratën.

3. TRANSAKSIONET/VEPRIMET E LEJUARA PËRMES BPB INSTA PAY

Aplikacioni Insta Pay ju ofron informata rreth bilancit të llogarisë, aplikim për kredi dhe ofron mundësinë e realizimit të transaksioneve brenda llogarive rrjedhëse EUR përmes numrit te telefonit apo kodit QR, në mes të klientëve të bankës përdorues të aplikacionit BPB InstaPay:

Pasi të jeni kyçur, aplikacioni BPB Insta Pay do të shfaq të dhënat e mëposhtme:

- Emrin dhe mbiemrin e përdoruesit të aplikacionit
- Gjendjen e llogarisë
- Numrin e llogarisë rrjedhëse
- Numrin e telefonit



Fusha "**Na kontakto**" ju mundëson kontaktin me bankën përmes Qendrës se Thirrjeve.

Fusha "**Na shkruaj**" ju mundëson kontaktin me bankën përmes emalit.

Fusha "**Kushtet dhe afatet e përgjithshme**" ju mundëson ri-leximin e përmbajtjes së këtij dokumenti në çdo kohë.

Në butonin e dytë në aplikacionin BPB Insta Pay ofrohen dy mundësi:

- Kërkesa për kredi
- Regjistrim i transfereve përmes listës së kontakteve



Fusha **"Kërkesa për kredi"** ju mundëson aplikimin online për kredi duke e ridrejtuar në linkun e ueb faqes së bankës.

Fusha **"Kontaktet e lidhura"** ju mundëson regjistrimin e transaksioneve përmes listës së kontakteve të cilët i keni të regjistruar në telefon. Në listë shfaqen vetëm kontaktet të cilët janë përdorues të aplikacionit BPB InstaPay.

Regjistrimi i transaksioneve përmes listës së kontakteve



Për të iniciuar një transaksion, ju duhet të zgjedhni numrin e telefonit përfitues respektivisht kontaktin, të shënoni vlerën e transferit dhe përshkrimin. Në ketë hap do të keni mundësi të përzgjedhni njërin nga dy opsionet:

- **Transferoj** mjete te përfituesi/kontakti, që nënkupton dërgim të mjeteve te kontakti i përzgjedhur

- **Kërkoj** mjete nga kontakti, që nënkupton paraqitjen e kërkesës për pranim të mjeteve / huazim nga kontakti i përzgjedhur

Transferimi i mjeteve

Pasi të keni përzgjedhur kontaktin përfitues dhe të keni plotësuar vlerën dhe detajet e transaksionit, për të përfunduar kërkesën duhet të shtyni butonin **"Pajtohem".**



Për transaksionet në vlerë mbi 1,000 EUR, ju duhet të konfirmoni veprimin duke shënuar kodin një përdorimesh të pranuar përmes SMS-it.

Shuma maksimale për transferim/pranim/është 9,999 EUR.



Kërkesa nga kontaktet

Pasi të keni përzgjedhur kontaktin prej të cilit do të kërkoni mjete, plotësuar vlerën dhe detajet e transaksionit, për të përfunduar kërkesën duhet të shtypni butonin **"Pajtohem".**

Klienti i përzgjedhur nga i cili janë kërkuar mjetet do të pranoj një njoftim në telefonin e tij/saj me tekstin **"Keni kërkesë nga 'emri mbiemri' në shumë xxx Euro "** dhe i/e njëjti do të ketë mundësi të aprovoj apo refuzoj kërkesën, si në vazhdim:

Ju jeni duke transferuar te
August 11 and
+383
€22.00
Detajet: test kerkese
Close
Refuzo
Aprovo

Pas inicimit të kërkesës, do të pranoni në telefon njoftimin nëse kërkesa juaj është pranuar apo refuzuar.

Në anën tjetër, klienti i përzgjedhur nga i cili janë kërkuar mjete ka mundësi të mos ndërmarr asnjë veprim duke shtypur butonin **"Mbyll"**. Kërkesa do të qëndroj në listën e transaksioneve në pritje për 60 minuta dhe nëse brenda këtij afati klienti të cilit i janë kërkuar mjetet nuk ndërmerr asnjë veprim, kërkesa do të largohet automatikisht nga lista.



Historiku i transaksioneve

Ne butonin e tretë në aplikacionin e BPB Insta Pay ju shfaqen transaksionet e iniciura përmes këtij aplikacioni, të ndara sipas statusit **"përfunduar"** apo **"në pritje"** për 6 muajt e fundit:



Transaksionet e listuara me ngjyrë të gjelbërt paraqesin transferet hyrëse, ndërsa ato me ngjyrë të portokalltë paraqesin transferet dalëse.

Për më tepër, mund të klikohet mbi transaksion dhe do të shfaqet edhe përshkrimi i transferit.

Transferi i mjeteve përmes QR Kodit

Pagesa apo transferi i mjeteve permes aplikacionit BPB Insta Pay mundësohet edhe përmes gjenerimit dinamik të kodit QR, në butonin e katërt të aplikacionit.



Në vazhdim janë të sqaruar hapat që duhet ndjekur për tërealizuar këto transaksione.

Gjenerimi QR Kodit

Pas përzgjedhjes së ikonës së QR Kod, ju duhet të përcaktoni shumën dhe vendosni përshkrimin e pagesës. Më pas shtypni butonin **"vazhdo"** dhe do të gjenerohet QR Kod, kod ky i cili mund t'i prezantohet klientit që do të realizoj pagesën.



Paguesi i cili paraprakisht është i pajisur me aplikacionin BPB Insta Pay, duhet të skanoj QR Kodin dhe më pas të Aprovoj apo Refuzoj pagesën.



4. DALJA NGA APLIKACIONI

Për të mbyll aplikacionin, klienti ju duhet të shtypni butonin "**Dalje**" ne dritaren e parë dhe të konfirmoni daljen duke shtypur "**Në rregull**".



Nëse ju nuk e përdorni aplikacionin për një interval të caktuar kohor dhe harroni të shtypni butonin **"Dalje"**, aplikacioni do të mbyllet automatikisht.

5. RESETIMI I FJALËKALIMIT

Nëse ju gaboni fjalëkalimin 3 herë radhazi, qasja në aplikacion do t'ju bllokohet.

Për të aktivizuar shërbimin, do të keni mundësinë që përmes opsionit **"Keni harruar fjalëkalimin"** të resetoni fjalëkalimin dhe aktivizoni shërbimin.

Nëse ju harroni fjalëkalimin, atëherë përmes opsionit **"Keni harruar fjalëkalimin"** mund të bëni resetimin e fjalëkalimit dhe të vendosni fjalëkalimin e ri.



Pasi të keni selektuar butonin "**Keni harruar fjalëkalimin**", duhet të mbushen fushat me:

- -Numrin e llogarisë
- katër numrat e fundit të numrit të kartelës
- numrin e telefonit



Pasi të jenë plotësuar fushat më lart, ju duhet të vendosni fjalëkalimin e ri, dhe të shënoni kodin e pranuar me SMS ku më pas pranoni njoftimin që fjalëkalimi i juaj është ndryshuar me sukses



6. NDRYSHIMI I NUMRIT TË TELEFONIT DHE DEAKTIVIZIMI I SHËRBIMIT BPB INSTA PAY

Në rast se ndryshoni numrin e telefonit, ju duhet të paraqiteni në degë dhe të ndryshoni informatat.

Në rast se ju dëshironi të mbyllni produktin e BPB Insta Pay, duhet të paraqitni kërkesën për mbyllje në njërën nga degët më të afërta.